

PARIMET E EKONOMISË

- 10 Parimet e ekonomisë (4 plus 3 plus 3)
- 1-4 Si individët i marrin vendimet e tyre (parimet e vendosjes individuale);
- 5-7 Si individët ndikojnë dhe ndërveprojnë njeri në tjetrin (ndërvarëshmëria e tyre)
- **8-10** Si funksionon ekonomia

Parimi 1: Individët gjithëherë ndeshen me zgjedhjen

- Rrallësia i detyron individët që të bëjnë zgjedhje. Në rastet kur një resurs është i rrallë, individët patjetër duhet të bëjnë zgjedhjen në mes të një produkti (një të mire) të dobishëm dhe atij më pakë të dobishëm;
- Çdo individ racional ballafaqohet me dilemën: se a të plotësoj më shumë një kërkesë, respektivisht të plotësoj më pakë kërkesën tjetër.

Parimi 1: Individët gjithëherë ndeshen me zgjedhjen

- Shpërndarja e kohës së lirë;
- Shpërndarja e buxhetit të amvisërisë;
- Shpërndarja e buxhetit për marketing;
- Shpërndarja e të ardhurave kombëtare për t'i shpenzuar për armatim ose për të mira konsumuese;
- Shpërndarja e barrës tatimore në qytetar/firmë (tatimi linear apo ai proporcional)
- Dhënja e prioritetit, efikasitetit apo drejtësisë

2. Kostot (Shpenzimet) oportune

- Duke bërë zgjedhjen në mes të dy mundësive alternative, ne bëjmë sakrifikimin e mundësisë së lëshuar;
- Vlera e të së mirës apo shërbimit të sakrifikuar quhet kostoja oportune;
- Gjatë zgjedhjes së alternativave të ndryshme ne bëjmë krahasimin e shpenzimit dhe dobisë të çdo alternative të mundshme (a është dobia e zgjedhjes së një alternative e vlefshme ndaj shpenzimit të plotë oportun);

2. Kostot (Shpenzimet) oportune

- Të regjistrohemi në fakultet apo jo;
- Të zgjedhim profesionin X apo Y;
- Shembulli: blerja e dy të mirave – sa do të sakrifikojmë njësi të së mirës A, për të rritur konsumin (shpenzimin) e të së mirës B për një njësi.

2. Kostot (Shpenzimet) oportune (SHEMBULLI)

- Kostoja mesatare e studimit në SHBA në vitin 1994 ishte 14.000\$ në vit, duke përfshirë edhe shpenzimet për literaturë dhe udhëtime. Në këtë shumë nuk janë të përfshira kostot oportune, pasi që studenti nëse do të punonte në një punë të caktuar, në vend që të studionte do të mund të fitonte 16.000\$ në vit. Fitimi i sakrifikuar (lëshuar) prej 16.000\$ është kostoja oportune e studentit. Kostoja reale e studimit për një vit nuk është 14.000\$, por në realitet 30.000\$, nëse përfshihen edhe kostot oportune.

3. Individët racional mendojnë për vlerat kufitare (marxhinale), si për dobinë ashtu dhe për kostot marxhinale

- A duhet t'i vazhdojë studimet edhe për 2 vite në studimet master apo jo; a duhet rritur vëllimin e prodhimit edhe për 1 njësi; a duhet blerë edhe 1 njësi të së mirës A apo jo, etj.?
- Ndryshimet marxhinale nënkuptojnë procesin e përhershëm të përshtatjeve të vogla për planet tona ekzistuese të veprimit;
- Çdo marrës racional i vendimeve, vendimin e merrë vetëm në rast se dobia e tij marxhinale tejkalonë (ose është më e madhe) se kostot e tija marxhinale.

4. Individët reagojnë ndaj ndryshimeve dhe stimulseve

- Individët ndryshojnë sjelljen e tyre me ndryshimin e raporteve në mes dobisë dhe kostove, d.t.th. Se ata reagojnë ndaj ndryshimeve;
- Ndikimi i ndryshimit të çmimit në kërkesën ose ofertën e një të mire;
- Ndikimi i rritjes së çmimit në shpenzimin e derivateve të naftës;
- Politika e sigurisë në komunikacionë, përdorimi i rrypave të sigurisë osë shpejtësia.

5. Tregtia çdo kend mund ta sjellë në pozitë më të mirë

- Tregtia i mundësonë individëve, firmave apo shteteve që të specializohen për ato që më së miri mund ta prodhojnë, respektivisht në ato veprimtari ku mund të kenë përparësi komparative;
- Nëse tregtohet edhe me të tjerët, konsumatorëve ju mundësohet që të blejnë më shumë të mira dhe shërbime me çmime më të lira;
- Ky parim shpjegon edhe arsyen pse shtetet tregtojnë njeri me tjetrin, rasti i SHBA-ve dhe Kinës etj.

6. Tregu sipas rregullit është mënyra më e mirë për organizimin e aktiviteteve ekonomike

- Ekonomia e planifikuar- e centralizuar (dora e dukshme) dhe ekonomia e tregut – e decentralizuar (dora e padukshme);
- Veprimi i ndërsjellë i individëve në ekonominë e tregut nuk mbështetet në dashurinë e pritur, humanizmin apo në solidaritet, por në dobitë dhe interesat personale. Duke zbatuar interesin personal, të orientuar nga dora e padukshme e tregut, individët përparojnë dhe interesin e shoqërisë në tërësi;

6. Tregu sipas rregullit është mënyra më e mirë për organizimin e aktiviteteve ekonomike

- Ekonomia e tregut alokon resurset përmes vendimeve të decentralizuara të shumë firmave dhe amvisërive në procesin e veprimit të ndërlidhur në tregun e mallrave dhe shërbimeve;
- Amvisëritë marrin vendimet se çka do të blejnë dhe për kë do të punojnë,
- Firmat marrin vendime se çka do të prodhojnë dhe kë do ta punësojnë;

6. Tregu sipas rregullit është mënyra më e mirë për organizimin e aktiviteteve ekonomike

- Çmimet janë një instrument shumë i rëndësishëm përmes të cilës dora e padukshme i orienton aktivitetet ekonomike;
- Çmimet që lirshëm formohen në tregun e caktuar pasqyrojnë edhe vlerën e ndonjë të mire apo shërbimi për shoqërinë, por dhe koston që e bartë shoqëria për të prodhuar atë të mirë ose shërbim;
- Ndikimi i tatimit në alokimin e resurseve;
- Ndikimi i çmimeve të kontrolluara në alokimin e resurseve.

6. Tregu sipas rregullit është mënyra më e mirë për organizimin e aktiviteteve ekonomike

- Aftësia e individit ose grupit të caktuar të individëve që të bëjnë ndikim të theksuar në çmimet e tregut;
- Shpërndarja më e drejtë dhe humane e mirëqenjes ekonomike;

Mungesat e tregut janë:

- **Eksternalitë** – ndikimi i veprimit të një individi në mirëqenjen e individit tjetër, me ç'rast dobitë ose kostot e personave të tretë nuk janë të përfshira në çmimin prodhues;

6. Tregu sipas rregullit është mënyra më e mirë për organizimin e aktiviteteve ekonomike

- **Të mirat publike** – janë të mira që janë të parapara për konsum final, me ç'rast çdo kush mund ti shfrytëzojë në sasi të njëjta, pa marrë parasysh se a paguan ose nuk paguan për përdorimin e tyre;
- **Monopolet (Monopsonet)** – shitësi ose blerësi i vetëm në tregun e caktuar, ku mund të na paraqitet, ngritja e çmimeve, zvogëlimi i sasisë së ofruar të të mirave ose shërbimeve, ulja e cilësisë etj.

7. Qeveritë nganjëherë janë në gjendje që të përmirësojnë rezultatet dhe efektet e tregut

- Pse është e domosdoshme intervenimi i shtetit në treg? Për të mbrojtur dorën e padukshme.
- Tregjet funksionojnë vetëm nëse me ligje ose akte tjera nënligjore mbrohen të drejtat pronësore, respektohen obligimet kontraktuese, kompenzimi i dëmit, procedura e falimentimit etj.
- Sistemi stabil juridik dhe rregullativa efikase ligjore – është tërësia e rregullave të harmonizuara me të cilat përcaktohen detyrat dhe përgjegjësit e subjekteve ekonomike,

8. Standardi jetësor i individëve të një shteti varet nga aftësia për të prodhuar të mira dhe shërbime

- Standardi jetësor në një shtet varet nga shkalla – niveli i produktivitetit të punës;
- Produktiviteti i punës është sasia e të mirave dhe shërbimeve të prodhuara për një njësi të kohës së punës;
- Produktiviteti i punës nuk është gjithçka, por në afat të gjatë ai është gjithçka (Paul Krugman);

Standardi jetësor mund të matet në mënyra të ndryshme:


- Me krahasimin e pagave, dhe
- Duke krahasuar vlerën e tërësishme të tregut të prodhimit kombëtar (GDP)

9.Çmimet rriten kur shteti shtyp (emiton) më shumë kartëmonedha (para)

- Në rastet kur shteti shtyp më tepër kartëmonedha, vëderi tek inflacioni, që paraqet rritjen e tërësishme të nivelit të çmimeve në atë shtet;
- Shkaku parësor i paraqitjes së inflacionit është rritja e sasisë së parasë në shtetin e caktuar.

10. Çdo shoqëri në afat të shkurtër ballafaqohet me zgjedhjen në mes inflacionit dhe papunësisë

- Në rastet kur rritet sasia e parasë në qarkullim, vie deri tek ngritja e përgjithshme e çmimeve – inflacioni, por në afat të shkurtër deri tek zvogëlimi i papunësisë (Lakorja e Filipsit).



R E Z I M E

- 1. Vendimarrja individuale nënkuptonë zgjedhjen në mes qëllimeve alternative;
- 2. Kostot e cilit do aktivitet përlogariten (maten) me dobinë e humbur të rastit më të mirë të lëshuar;
- 3. Individët racional vendimet e tyre i marrin gjithëherë duke i krahasuar kostot dhe dobitë e tyre marxhinale (kufitare);
- 4. Individët i ndryshojnë sjelljet e tyre në raport me stimulset që ju ofrohen;

R E Z I M E

- 5. Tregtia sjellë dobi të dyanëshme;
- 6. Tregjet zakonisht janë mënyra më e përshtatshme e organizimit të aktiviteteve ekonomike;
- 7. Qeveritë mund të përmirësojnë rezultatet e veprimit të tregut me qëllim të avancimit të aktiviteteve ekonomike dhe zbatimit të drejtësisë në shpërndarje;

R E Z I M E

- 8. Produktiviteti i punës është burimi kryesor i shtimit të standardit jetësor;
- 9. Shtimi i sasisë së parasë është burimi parësor i inflacionit;
- 10. Çdo shoqëri ballafaqohet në afat të shkurtër me problemin në mes të inflacionit dhe papunësisë.

Ekonomia si veprimtari racionale

- **QËLLIMET**

1. Duhet të ekzistojnë **më shumë qëllime**
2. **Rangohen** sipas rëndësisë dhe urgjencës


- **MJETET-
Instrumentet**

1. Mjetet duhet të jenë të **kufizuara**
2. Mund të përdoren në mënyrë **alternative**

SISTEMET EKONOMIKE

- **Resurset**
- **Subjektet ekonomike**
- **Aktivitetet ekonomike**
- **Institucionet**


RESURSET



SUBJEKTET EKONOMIKE


- **Firmat** - prodhojnë të mira materiale dhe kryejnë shërbime
- **Amvisëritë** – maksimizimin e dobisë në konsum përmes rangimit të preferencave,
- **Shteti**- ofrimi i të mirave publike, rregullimi makroekonomik, siguria nacionale, stabiliteti i brendshëm etj.
- **Bota e jashtme**

AKTIVITETET EKONOMIKE



INSTITUCIONET

- Institucionet – janë forma të ndërlidhjes së përhershme në mes të subjekteve të ndryshme ekonomike (rregullimi, parashiqimi dhe stabiliteti i sistemit ekonomik)



- “Rregullat e sjelljes” dhe “Rregullat e lojës”
- Pronësia
- Tregu